



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО - UNIVERSITY OF TETOVA

Bul. "Ilinden" p.n. 1200 Tetovë | Tel: +389 44 356 500 | Fax: +389 44 356 222
e-mail: international@unite.edu.mk | www.unite.edu.mk

NJOFTIM

Njoftohen të interesuarit se **Buletini nr. 138** i Universitetit të Tetovës është publik dhe i njëjti mund të shikohet nga të interesuarit te Dekanët e fakulteteve të Universitetit të Tetovës.

Buletini do të jetë publik duke filluar nga 11.12.2018 deri më 25.12.2018.

Tetovë, 11.12.2018



REFERAT

Në bazë të konkursit për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi për lëndët: Patofiziologji dhe Mjekësi interne në Fakultetin e shkencave mjekësore të Universitetit shtetëror të Tetovës të datës 26.09.2018 të shpallur në gazetën “Koha” dhe “Nova Makedonija” dhe në ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës: “www.unite.edu.mk”, me propozim të Këshillit mësimor - shkencor të Fakultetit të shkencave mjekësore nr. 22-2223/1 të datës 19.10.2018 dhe me vendim të Këshillit të rektoratit nr. 02-5074/1 të datës 21.11.2018 formohet Komisioni recensues në përbërje:

- 1. Prof.dr. Nexhmedin Kahremani– kryetar.** (Profesor inordinar ne Fakultetin e Mjekesise ne USHT ne Tetove).
- 2. Prof.dr. Mimoza Lezha– anëtar** (Profesor ordinar, Departamenti i Kardiologjise ne Spitalin Univesitar Nena Tereze).
- 3. Prof.dr. Idriz Balla – anëtar** (Profesor ordinar, Departamenti i Kardiologjise ne Spitalin Univesitar Nena Tereze).

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me konkursin e lartpërmendur, dhe në përputhje me nenin 166 dhe nenit 172 të Ligjit për arsim të lartë (“Gazeta Zyrtare e RM-së” Nr. 82/2018), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve në Universitetin shtetëror të Tetovës, i paraqet Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të shkencave mjekësore dhe Këshillit të rektoratit të Universitetit të Tetovës këtë:

RECENZION

Në konkursin e datës 26.09.2018 të shpallur në gazetën “Koha” dhe “Nova Makedonija” dhe në ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës: “www.unite.edu.mk”, për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: 1. Patofiziologji dhe 2. Mjekësi interne, në Fakultetin e shkencave mjekësore të Universitetit të Tetovës, **u paraqit vetëm një kandidat:**

Doc. Dr. Atilla Rexhepi

Shënime biografike:

Doc. Dr. Atilla Rexhepi është kardiolog specialist, i punësuar në Fakultetin e shkencave mjekësore të Universitetit të Tetovës. Ka lindur më 11 dhjetor 1961 në Tetovë. Shkollën fillore e ka kryer në Tetovë, kurse shkollën e mesme e ka kryer në Prishtinë. Fakultetin e mjekësisë e regjistroi në Prishtinë në vitin 1980, ku u diplomua në vitin 1986 me notë mesatare 8,6.

Pas diplomimit dhe stazhit të detyrueshëm një vjeçar, punoi si mjek në shtëpinë e shëndetit në Prishtinë.

Nga viti 1988 u punësua dhe për dy vite punoi në Klinikën universitare të Kirurgjisë dhe Ortopedisë në Prishtinë.

Në vitin 1991, regjistroi studimet pasuniversitare në Fakultetin e mjekësisë të Universitetit të Tiranës në degën e kardiologjisë, ku të gjitha provimet i mbaroi me sukses maksimal, me notë mesatare 9,9. Provimin specialistik e dha në vitin 1996 dhe fitoi titullin – **specialist për kardiologji**.

Nga viti 1997 deri më 2008, e drejtoj dhe punoi si specialist kardiolog në Institucionin privat shëndetësor për mjekësi interne dhe kardiologji në Tetovë.

Nga viti 2008 deri më 2011 punoi si drejtor i Spitalit Klinik në Tetovë.

Në prill të vitit 2010, pas përfundimit të provimeve të magjistraturës me notë mesatare 9,75 e mbrojti me sukses tezën e magjistraturës me titull: “Disperzioni i segmentit QT dhe aritmive ventrikulare në pacientët hipertenziv me dhe pa hipertrofi të ventrikulit të majtë”, dhe fitoi titullin Magjistër i Shkencave Mjekësore.

Nga viti 2011 është pranuar në marrëdhënie të rregullt të punës - asistent në Fakultetin e shkencave mjekësore pranë Universitetit shtetëror të Tetovës, ku ka mbajtur pjesën praktike të ligjëratave në lëndët: “Patofiziologji” dhe “Mjekësi Interne” në kuadër të Fakultetit të mjekësisë, stomatologjisë dhe farmacisë.

Në dhjetor të vitit 2012 kandidati mbrojti disertacionin e doktoraturës me titull "Sindroma metabolike në popullsinë adulte në rajonin e Tetovës " në Fakultetin e shkencave mjekësore teknike në Tiranë, pranë Universitetit të Tiranës.

Në dhjetor të vitit 2013 zgjidhet Docent në Fakultetin e mjekësisë pranë Universitetit shtetëror të Tetovës ku ka ligjeruar lëndët: Patofiziologji dhe Mjekësi Interne.

Dr.sc. Atila Rexhepi është anëtar i Shoqatës Europiane të Kardiologjisë, Shoqatës Maqedonase për Kardiologji, Shoqatës Shqiptare të Kardiologjisë dhe anëtar i Shoqatës së Mjekëve Shqiptarë.

Aktiviteti profesional:

Në vitin 1991 për tre muaj ka qëndruar për specializim në Qendrën klinike në Lublanë. Në vitin 1996 DHE 2007 ka qëndruar në Qendrën për kirurgji torakale dhe kardiake “Sijami Herceg” në Stamboll, ku mori pjesë në mënyrë aktive në punën e kabinetit për ekokardiografi DHE për kardiologji invasive.

Ka marrë pjesë në kongrese të organizuara nga Shoqata Evropiane e Kardiologjisë në Vjenë në vitin 2007, Barcelona në vitin 2009, Stokholm 2010, Mynih 2012, Amsterdam 2013, Barcelona 2014, London 2015, Roma 2016.

Aktiviteti mësimor

Nga viti 2009 ai ka qenë i angazhuar në aktivitet mësimor në Fakultetin e shkencave mjekësore në Tetovë në lëndët Mjekësi Interne dhe Patofiziologji, kurse pas punësimit si bashkëpunëtor-asistent në po këtë Universitet në vitin 2011, ka vazhduar të mbaj pjesën praktike të mësimit nga lënda e Patofiziologjisë në kuadër të Fakultetit të shkencave mjekësore.

Në dhjetor te vitit 2013 zgjidhet Docent ne Fakultetin e mjekësisë pranë Universitetit shtetëror të Tetovës ku ka ligjeruar lëndët: “Patofiziologji” dhe “Mjekësi Interne”.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), **kandidati Atilla Rexhepi per 5 vitet e fundit ka realizuar gjithsej 46.1 pikë nga veprimtaria mësimore-arsimore.**

Aktiviteti shkencor dhe kërkimor:

Në mënyrë aktive ka qenë i angazhuar në aktivitete të ndryshme kërkimore-shkencore në fushën e kardiologjisë, me pjesëmarrje në takime kombëtare dhe ndërkombëtare profesionale, simpoziume, konferenca dhe kongrese si dhe publikime te punimeve neper revista shkencore dhe profesionale.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i i universitetit), kandidati Atilla Rexhepi **per 5 vitet e fundit ka realizuar gjithsej 55.2 pikë nga veprimtaria shkencore-hulumtuese.**

Aktivitete me interes të përgjithshëm:

Dr. Sc. Atilla Rexhepi ka qenë dhe është i angazhuar edhe në aktivitete tjera me interes të përgjithshëm shëndetësor profesional. Ka qenë anëtar në komisionin e Ministrisë së shëndetësisë për dhënien e titullit “Primarius”, anëtar në Komisionin e Ministrisë së shëndetësisë për listën pozitive të barnave, anëtar i Komisionit të shkallës së dytë në Fondin e shëndetësis për trajtim të të sëmurve jashta vendit dhe anëtar i Komisionit për çështje etike dhe ligjore në Dhomën e mjekëve të Maqedonisë. Aktualisht eshte redaktor i revistës shkencore për mjekësi – Medicus si dhe anëtar i këshillit redaktues i revistes profesionale te Dhomes se Mjkeve “Vox Medici”.

Në përputhje me Rregulloren dhe procedurën për zgjedhjen në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e

Tetovës (Buletini i i universitetit), kandidati **Atilla Rexhepi** ka realizuar gjithsej **12 pikë nga veprimtaria interes te pergjithshem.**

FORMULARI PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE

Në shtojcën e mëposhtme është bashkangjitur formulari për raportin e zgjedhjes në thirrjen mësimore-shkencore. Kandidati Dr. Atilla Rexhepi për 5 vitet e fundit ka grumbulluar gjithsej 113.3 pikë, edhe atë për veprimtarinë mësimore-arsimore 46.1 pikë, veprimtarinë shkencore-hulumtuese 55.2 pikë, dhe veprimtarinë me interes më të gjerë 12 pikë.

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJE	PIKË
VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	46.1**
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	(100.3)*55.2
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE DHE ME INTERES TE GJERE	12**
Gjithsej	(158.2)* 113.3**

*Kumulativ, ** 5 vitet e fundit

VLERËSIM DHE PROPOZIM

Në bazë të pasqyrës së prezantuar më lartë, si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni Recensues konstaton dhe vlereson si më poshtë:

- Konstaton kontinuitetin dhe kompatibilitetin shkencor dhe profesional të studimeve me lëndët e shpallura në konkurs.

- Vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore të kandidatit pasi konstatoi që gjatë punës për disa vite në cilësinë e Asistentit dhe Docentit në po këtë fakultet ka dëshmuar sjellje pedagogjike, të përgjegjëshme dhe serioze me studentët.

- Vlerësoi pozitivisht aktivitetin shkencor dhe kërkimor, pasi konstatoi përvojën akademike, publikime të mjaftueshme, dhe pjesëmarrje në konferenca, seminare dhe kongrese kombëtare dhe ndërkombëtare.

Duke u bazuar ne vlerësimet e lartëpërmendur komisioni recenzues konstaton se kandidati Doc. Dr Atilla Rexhepi në përputhje me Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtorëve në Universitetin Shtetëror të Tetovës ka grumbulluar gjithsej **113.3 pikë** nga referencat profesionale duke plotësuar keshtu të gjitha kushtet ligjore, profesionale dhe të tjera për thirrje mësimore Profesor Inordinar të parapara në nenin 166 dhe nenit 172 të Ligjit për arsim të lartë (“Gazeta Zyrtare e RM-së” Nr. 82/2018)

Komisioni recensues ka nderin që t'i propozon Këshillit të Rektoratit të Universitetit shtetëror të Tetovës, që **Doc. Dr. Atilla Rexhepi** të zgjedhet mësimdhënës në thirrjen mësimore **Profesor Inordinar** për lëndët: **Patofiziologji** dhe **Mjekësi interne** në Fakultetin e shkencave mjekësore të Universitetit shtetëror të Tetovës

K O M I S I O N I R E C E N Z U E S :

1. Prof.dr. Nexhmedin Kahremani– kryetar

2. Prof. Dr. Mimoza Lezha, anëtar

3. Prof.dr. Idriz Balla – anëtar

SH T O J C Ë

PËR RECENSIONIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE, SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: Atilla Rexhepi

Institucioni: Fakulteti i Shkencave Mjekësore - Universiteti i Tetovës, Tetovë

Lëmia shkencore: Mjekësi interne - Patofiziologji

VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

	Emri i aktivitetit	Kalkulimi	Pikët
1	Mbajtja e ligjeratave në ciklin e parë të studimeve		35.4
1.1	Viti akademik 2013/2014 - semestri veror		
1.1.1	Mjekësi Interne II	3x15x0.04	1.8
1.1.2	Patofiziologji I	3x15x0.04	1.8
1.1.3	Mjekësi familjare	1x15x0.04	0.6
1.2	Viti akademik 2014/2015 - semestri dimëror		
1.2.1	Mjekësi Interne I	3x15x0.04	1.8
1.2.2	Patofiziologji II	2x15x0,04	1.2
1.2.3	Mjekësi familjare	1x15x0.04	0.6
1.3	Viti akademik 2014/2015 - semestri veror		
1.3.1	Mjekësi Interne II	3x15x0.04	1.8
1.3.2	Patofiziologji I	3x15x0.04	1.8
1.3.3	Mjekësi familjare	1x15x0.04	0.6
1.4	Viti akademik 2015/2016 - semestri dimëror		
1.4.1	Mjekësi Interne I	3x15x0.04	1.8
1.4.2	Patofiziologji II	2x15x0,04	1.2
1.4.3	Mjekësi familjare	1x15x0.04	0.6
1.5	Viti akademik 2015/2016 - semestri veror		

1.5.1	Mjekësi Interne II	3x15x0.04	1.8
1.5.2	Patofiziologji I	3x15x0.04	1.8
1.5.3	Mjekesi familjare	1x15x0.04	0.6
1.6	Viti akademik 2016/2017 - semestri dimëror		
1.6.1	Mjekësi Interne I	3x15x0.04	1.8
1.6.2	Patofiziologji II	2x15x0,04	1.2
1.6.3	Mjekesi familjare	1x15x0.04	0.6
1.7	Viti akademik 2016/2017 - semestri veror		
1.7.1	Mjekësi Interne II	3x15x0.04	1.8
1.7.2	Patofiziologji I	3x15x0.04	1.8
1.7.3	Mjekesi familjare	1x15x0.04	0.6
1.8	Viti akademik 2017/2018 - semestri dimëror		
1.8.1	Mjekësi Interne I	3x15x0.04	1.8
1.8.2	Patofiziologji II	2x15x0,04	1.2
1.8.3	Mjekesi familjare	1x15x0.04	0.6
1.9	Viti akademik 2017/2018 - semestri veror		
1.9.1	Mjekësi Interne II	3x15x0.04	1.8
1.9.2	Patofiziologji I	3x15x0.04	1.8
1.9.3	Mjekesi familjare	1x15x0.04	0.6
2	Konsultime me studentë		0.70
2.1	Mjekësi Interne I	60x0.002	0.12
2.2	Mjekësi Interne II	40x0.002	0.08
	Patofiziologji I	150x0.002	0.3
	Patofiziologji II	100x0.002	0.2
3	Mentor për mbrojtjen e temës në ciklin e parë		10
3.1	Anetar i komisionit per mbrojtje te temes se diplomes	15X0.2	3
3.2	Anetar i komisionit per mbrojtje te temes se magjistratures	7x1	7
	Totali i pikëve nga veprimtaria mësimore-arsimore		46.1

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikët
1	Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë referente shkencore/profesionale me bord ndërkombëtar	79.2(46.2)
1.1	Rexhepi A , Jani Y; Dispersioni I Qt Intervalit Te Hipertensivet Me Dhe Pa Hipertrofi Te Ventrikulit Te Majte, Medicus Supplement 3: 57-66 2008	5.4
1.2	Rexhepi A ; Relacioni Ndermjet Disperzionit Te Qt Intervalit Dhe Aritmive Ventrikulare Te Pacientet Hipertensiv, Medicus Supplement 5: 110-121, 2010	6
1.3	Rexhepi A ; Abdominal Obesity Is The Most Common Component Of Metabolic Syndrome In Hypertensive Patients In Tetova Region; Arhives Of Public Health Vol,4, No.1, 41-46 2012.	6
1.4	Rexhepi A , Dallimet Gjinore Ne Prevalence E Sindromit Metabolic Ne Mesin E Pacienteve Hipertensiv Te Rrethit Te Tetoves. Medicus 2012, Vol. 17(2):68-73	6
1.5	Rexhepi A , Aritmite Ventrikulare Komplekse Te Pacientet Hipertensiv Me Dhe Pa Hipertrofi Te Ventrikulit Te Majte" .. Mjekesia Bashkekohore Kujdesi Infermieror.Nr. 9. 2012 Fakulteti I Infermierise	6
1.6	Ismaili H, Rexhepi M, Rexhepi A , Ismaili E. Vlerat E Lipoproteinit(A) Tek Pacientet Me Artrit Reumatoid Te Pa Kuruar Dhe Te Kuruar, Medicus Supplement 6: 105, 2011	3.6
1.7	Jani Y, Kamberi A, Dali L, Gafur P, Iseni M, Mirto A, Ferati F, Zeqiri A, Rexhepi A , Orovcane N. Control Of Arterial Hypertension Among Type 2 Diabetics. International Journal Of Biomedicine 3(4) (2013) 232-239	3.6
1.8	Jani Y, Kamberi A, Ferat F, Rexhepi A , Pocest B, Orovcane N, Lala D, Polisi G, Iseni M, Mirto A, Zeqiri A. Influence Of Dyslipidemia In Control Of Arterial Hypertension Among Type-2 Diabetics In The Western Region Of The Republic Of Macedonia. Am J Cardiovasc Dis. 2014; 4(2): 58–69.	3.6
1.9	Jani Y, Kamberi A, Xhunga S, Pocesta B, Ferati F, Lala D, Zeqiri A, Rexhepi A . The Influence Of Type 2 Diabetes And Gender On Ventricular Repolarization Dispersion In Patients With Sub-Clinic Left Ventricular Diastolic Dysfunction Am J Cardiovasc Dis. 2015; 5(4): 155–166	3.6
1.10	Jani Y, Xhunga S, Serani A, Pocesta B, Ferati F, Lala D, Zeqiri A, Rexhepi A . Ventricular Repolarization: Epidemiology And Clinical Correlates Among Type-2 Diabetics With Uncontrolled Arterial Hypertension In Western Region Of The Republic Of Macedonia Open Journal Of	3.6

	Internal Medicine, 2016, 6, 43-55	
1.11	Pollozhani A, Rexhepi A , Iseni A., Tushi B. Bioethics Education In Medical Schools In Republic Of Macedonia. <i>Medicus</i> 2016, Vol. 21 (1): 18 - 24	3.6
1.12	Rexhepi A , Asani V. Congenital Left Ventricular Aneurysm With Ventricular Tachycardia In An Adult; <i>Medicus</i> 2016, Vol. 21 (2): 201 -209	5.4
1.13	Jani Y, Xhunga S, Serani A, Pocesta B, Ferati F, Lala D, Zeqiri A, Mirto A, Rexhepi A , Ahmet A. Control Of Diabetic Dyslipidemia Among Type-II Diabetics In Western Region Of The Republic Of Macedonia. <i>Advances In Diabetes And Metabolism</i> 2017, Vol. 5(2), Pp. 31 – 38	3.6
1.14	Rexhepi A , Jani Y, Pocesta B, Xhunga S, Serani A, Et Al. Effect Of Uncontrolled Diabetic Dyslipidemia In The Prevalence Of Sub-Clinic Left-Ventricular Diastolic Dysfunction In Western Region Of The Republic Of Macedonia. <i>J Res Diabetes Metab.</i> 2017;3(1): 036-042.	3.6
1.15	Atila Rexhepi , Nevzat Elezi, Ylber Jani . Prevalence Of Metabolic Syndrome In Adult Population Of District Of Tetovo In The Northwest Region Of The Republic Of Macedonia. <i>International Journal Of Medical Research & Health Sciences</i> , 2018, 7(3): 104-114 Issn No: 2319-5886	4.8
1.16	Atila Rexhepi , Bekim Ismaili , Nevzat Elezi , Shaban Memeti , Hysni Ismaili. Prevalence, Awareness And Risk Factors Of Diabetes And Prediabetes Among Adult Population Of Tetovo Region In Republic Of Macedonia . <i>Medicus</i> 2018, Vol. 23 (1): 7-12	3.6
1.17	Atila Rexhepi , Meral Rexhepi , Shaban Memeti , Ylber Jani , Nevzat Elezi. Association Of Socio-Economic Status With Metabolic Syndrome – The Case Of The Northwest Region Of The Republic Of Macedonia. <i>International Journal Of Medical Sciences And Innovative Research</i> , 2018. Volume – 3 (3): 209 – 216	3.6
1.18	Jani Y, Rexhepi A , Pocesta B, Xhunga S, Serani A, Ferati F, Lala D, Zeqiri A, Mirto A And Kamberi. Prevalence Of Subclinical Left Ventricular Diastolic Dysfunction In Patient With Metabolic Syndrome In West Region Of The Republic Of Macedonia. <i>Journal Of Clinical And Experimental Research In Cardiology</i> , 2018, Volume 4 Issue 1	3.6
2	Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në përmbledhje punimesh nga tubim shkencor me bord ndërkombëtar	8.1
2.1	Rexhepi A , Ismaili H. QT Disperzioni i rritur shoqerohet me aritmi ventrikulare komplekse te pacientet hipertenziv me hipertrofi te ventrikulit te majte. <i>Instituti Alb-Shkenca, Takimi i gjashte vjetor</i>	2.7

	nderkombetar, Libri i permbledhjeve 6: f 520, IASH 1-4 shtator 2011	
2.2	Rexhepi A , Rexhepi M. Dallimet gjinore ne prevalencen e sindromes metabolike ne mesin e pacientëve hipertensiv te rrethit te Tetoves - "Gender differences in prevalence of metabolic syndrome among hypertensive patients in the district of Tetovo", Instituti Alb-Shkenca takime vjetore, 29-31 gusht 2012, Shkup.	2.7
2.3	Rexhepi M, Rexhepi A . "Shëndeti urban në republikën e maqedonisë" "Urban health in the Republic of Macedonia" Instituti Alb-Shkenca takime vjetore, 29-31 gusht 2012, Shkup	2.7
3	Pjesëmarrje në takim shkencor/profesional me referat - prezentim oral	3(2)
3.1	Rexhepi A. Sindromi metabolik te pacientet me hipertension, Konferenca e pare Ballkanike per hipertensionin dhe riskun Kardiovaskular. 25 maj, 2012 USHT Tetove.	1
3.2	Atila Rexhepi. Semundjet kardiovaskulare te grate, Tribune Shkencore, Universiteti i Tetoves, 26 Shtator 2013	1
3.3	Rexhepi A, Neziri E, Zyberi F, Smakaj E, Bara P. Epidemiologjia e sindromës metabolike dhe determinantët e saj socioekonomik dhe bihevioral në mesin e popullatës së rritur në rajonin e Tetovës, Konferenca shkencore, Kodra e diellit, Tetove 2014	1
4	Abstrakt i botuar në librin e abstrakteve nga konferencat shkencore - ndërkombëtare	10(7)
4.1	Rexhepi A , Ismaili B, Emini E. "Metabolen sindrom megju hipertenzivnite pacienti koi se javuvaat na pregled kaj matichen lekar"(Metabolic syndrome in patients with arterial hypertension treated in general practice". III Congrec of GP/FM doctors of Republic of Macedonia, with international participation. 26-29 April 2012, Ohrid. Book of Abstracts, Makedonski medicinski pregled, God:66(supl 84) str. 1-232, 2012	1
4.2	Mentor Hamiti, Nevzat Elezi, Atila Rexhepi . ETHICAL USE OF INFORMATION TECHNOLOGY IN MEDICAL FACULTIES. 8-th International Conference on Bioethics Education, September 2-5, 2012, Israel	1
4.3	M. Lezha A. Gjata, E. Petrela, A. Rexhepi . The prevalence of anemia in chronic heart failure and associated factors, Takim profesional mjekesor, Tetor,26-27, 2012, Shkup	
4.4	Rexhepi A , Ismaili H, Elezi N, Ismaili B; Karakteristikat e sindromes metabolike te popullata adulte e rajonit te Tetoves Takim profesional mjekesor, Tetor, 26-27, 2013, Struge	1
4.5	Valon Asani, Omer Xhemali, Atila Rexhepi , Nexhbedin Beadini.	1

	“Sindroma akute koronare manifestimi faktorët e riskut dhe prezantimi i rastit të parë i punuar ne Qendrën për kardiologji intervente në Tetovë”. Konferenca e dyte shkencore nderkombtare Mjekësia Bashkekohore dhe metodat e aplikative ne trevat shqipfolse.25-26.04.2014.	
4.6	Azis Polozhani, Atila Rexhepi , Armend Iseni, Bardhyl Tusha; Ethics education in medical schools in Republic of Macedonia; Bioethics, Medical Ethics and Health Law, Royal Continental Hotel, Naples, Italy, October 20-22, 2015	1
4.7	Mimoza Lezha. Uliks Ekmekciu, Riana Gjypi, Eqerem Hasani, Atila Rexhepi ; Acidi urik si faktor rreziku per fibrilacion atrial dhe korrrrlacioni me atriumin e majte. Takim profesional mjekesor, 30 tetor-1 nentor 2015, Struge	1
4.7	Atila Rexhepi , Bekim Ismaili, Engin Emini, Burim Alimi. Metabolic syndrome among adult population in the region of Tetovo and its socioeconomic and behavioral determinants, XIX Congress of doctors of Republic of Macedonia with international participation 1-3 october, 2015 Skopje	1
4.8	Atila Rexhepi , Bekim Ismaili, Valon Asani “Prevalence Awernes and risk factor of diabetic and pediabeticss among adult population of Tetovo region in RM.” First internacional scientific conference of faculty of medical science (ISCF MS2016), 3 - 4 June 2016, ISBN 978-608-217-039-8	1
4.9	Atila Rexhepi , Ylber Jani. SEMUNDJA PERIFERIKE ARTERIALE ASIMPTOMATIKE TEK PACIENTET ME SINDROME METABOLIKE, Takim profesional mjekesor, 27-29 Tetor 2017, Struge.	1
4.10	Atila Rexhepi , Bekim Ismaili. Visceral obesity is the most comon component of metabolic syndrome in hypertensive patients attending a primary physician., Second international scientific conference of faculty of medical sciences 13-14 October 2017, Tetovo, Macedonia	
	Totali i pikëve nga veprimtaria shkencore - hulumtuese	100.3 (55.2)

VEPRIMTARITË ME INTERES TË GJËRË

Nr.	Emri i aktivitetit:	Pikët
1	Anëtar i këshillit organizues ose programor (shkencor) i tubimit ndërkombëtar shkencor/profesional	6

1.1	Takime profesionale mjekesore te SHMSHM 2014, 2015, 2016, 2017	4
1.2	1-st and 2-nd - international scientific conference of faculty of medical sciences , Tetovo , 2016, 2017.	2
2	Redaktor i revistes shkencore/profesionale nderkombetare	3
2.1	Redaktor i revistes shkencore/profesionale- MEDICUS	3
3	Anëtar i bordit editorial të revistës shkencore / profesionale	1
3.1	Anetar i bordit editorial te revistes profesionale “VOX MEDICI”	1
4	Pjesëmarrja në komisionet dhe organet e shtetit dhe organet e tjera	2
4.1	Komisioni i Fondit per Shendetesi per mjekime jashte shtetit	1
4.2	Anëtar i Komisionit për çështje etike dhe ligjore në Dhomën e mjekëve të Maqedonisë	1
Totali i pikëve nga veprimtaria me interes të gjërë		12

Tetovë, Tetor 2018

Komisioni recensues:

- 1. Prof.dr. Nexhbedin Kahremani– kryetar**
- 2. Prof.dr. Mimoza Lezha– anëtar**
- 3. Prof.dr. Idriz Balla – anëtar**
